



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË



Sheshi "Skënderbej", No. 1, Tirana - Albania • **Tel:** ++355 4 222230; 222750; 235568
• **Fax:** ++355 4 223558 • **Website** www.bankofalbania.org • **E-mail:** public@bankofalbania.org

NJOFTIM PËR SHTYP

1. NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË

1.1 Operacionet e tregut të hapur

Situata e likuiditetit në tremujorin e tretë të vitit 2004 u karakterizua nga tepricë likuiditeti megjithëse në nivele mesatare me të ulta krahasuar me tremujorin e kaluar. Për manaxhimin e likuiditetit, Banka e Shqipërisë ndërhyri me instrumentin kryesor të tregut në vlerë mesatare prej 2.8 miliardë lekë dhe paralelisht me të edhe me marreveshje riblerjeje me maturim njëmuajor perkatësisht në muajt korrik dhe gusht. Me qëllim drejtimin e nivelit të yield-ve në nivelin e përcaktuar nga politika monetare, Banka e Shqipërisë kufizoi shumën e tërhequr në ankandet e marrëveshjeve të riblerjes me maturim njëjavor të zhvilluara në tre javët e fundit të muajit gusht dhe në dy javët e para të muajit shtator.


Tabela e mëposhtme paraqet vëllimin (në milionë lekë) e likuiditetit të tërhequr nëpërmjet operacioneve të tregut të hapur.

Data	REPO javore	REPO njëmuajore
01.07.2004	4,005.00	4,000.00
08.07.2004	5,925.00	
15.07.2004	5,233.00	
22.07.2004	188.00	
29.07.2004	4,347.00	2,000.00
05.08.2004	3,532.00	
12.08.2004	1,500.00	
19.08.2004	376.00	
26.08.2004	2,127.00	
02.09.2004	1,500.00	
09.09.2004	1,500.00	
16.09.2004	3,279.00	
23.09.2004	2,740.00	
30.09.2004	3,307.00	

1.2 Përdorimi i instrumenteve mbështetës

Në mbështetje të instrumenteve të tregut të hapur, për investimin e likuiditeteve të lira bankat përdorën edhe depozitën njëditore, niveli mesatar ditor i të cilës ishte 1,204 milionë lekë. Mungesa e likuiditetit në ditë të veçanta, solli dhe përdorimin e kredisë njëditore, mesatarisht 357 milionë lekë në ditë. Kërkesa për kredi njëditore u përqëndrua kryesisht në muajt korrik dhe gusht si rezultat i keq-funksionimit të tregut ndërbankar.

Grafiku i mëposhtëm paraqet një përmbledhje të ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë gjatë nëntëmuajorit të vitit 2004.



Ulja e nivelit shkaktohet nga tërheqja e përhershme e likuiditetit me anë të transaksioneve outright

3. NDËRHJRJET NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Gjatë tremujorit të tretë Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në tregun e brendshëm valutor, në vijim të ndërhyrjes së nisur në javën e fundit të muajit qershor. Veprimet e realizuara me bankat e nivelit të dytë përfaqësojnë blerje të valutës Eur dhe Usd dhe janë kryer në muajt korrik dhe gusht. Gjatë kësaj periudhe janë tërhequr nga tregu i brendshëm valutor, në këmbim të vlerës 6.18 miliardë lekë, rreth 35.28 milionë Eur me kurs mesatar 124.64 lek/eur dhe rreth 17.46 milionë Usd me kurs mesatar 102.01 lek/usd.